

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Historia e 'kokës së prerë të Ali Pashës te Sulltani! Si përfundoi PIKTURA që flakën komunistët dhe e ble në grekët te holli i Porto Palermos
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kulture/historia-e-kokes-se-prere-te-ali-pashes-te-sulltani-s-i-perfundoi-piktura-i585930
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 06:57:28 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 14:54:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2fda29ee9080ff0ff66591a55007dec187fbeb66e0eee5668c1657be3bf50f30
TEKSTI	54ce0b78309bf97f5d516a3ecd478264f468c2458cbab73112ef1a18235061e9
PAMJA	f48c92c015d335dc8f8d009665945aabbca1db20dbbd15747141ec1d47b4bcd0

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3bef1366c94866eeaed498b4d4ea311c53cc1311351ac8586013c3319f1b0b1b
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3bef1366c94866eeaed498b4d4ea311c53cc1311351ac8586013c3319f1b0b1b>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)

English

ie [Viti i ri shkollor/ Presidenti Begaj uron nxenesit: E ardhmja eshte ne duart tuaja](#) [Magjistratet na treguan se problemi i Shqiperise jane vete ata. Rama e dinte](#) [Kreth 90 ban](#)
fundit

Historia e 'kokës së prerë të Ali Pashës te Sulltani! Si përfundoi PIKTURA që flakën komunistët dhe e blenë grekët te holli i Porto Palermos



14 Shtator 2026, 16:54 Kulturë TEMA



Piktura e stampuar me "kokën e prerë të Ali Pashë Tepelenës te Sulltani", qëndron aktualisht e varur në ambientet e brendshme të kalasë së Porto Palermos. Historia e saj vjen nga rrëfimi ekskluziv për MAPO i autorit të veprës, Agim Sulaj

"Kjo tablo me përmasa 180x170 u pikturua në vitin 1989, për të marrë pjesë në konkurimin kombëtar të përvjetorit "Pavarësia". Ishte një krijim imi, imagjinuar e krijuar në studion time në Vlorë," - thotë piktori, në rrëfimin e tij për "MAPO.al".

"Kompozimi dhe drama që përcjell tabloja janë mbresëlënëse. E kam punuar gati 25 ditë. Dhe e nisa në Tiranë për ekspozim, me trenin e linjës Vlorë-Tiranë. Që nisej në 4,30 të mëngjesit", shprehet Sulaj.

"Më ndihmuan e lagjes për ta çuar sepse tabloja ishte e madhe dhe me kornizë të plotë", thekson piktori.

Më tej, Sulaj shton se piktura u flak, pasi nuk mori pëlqimin e autoriteteve, për shkak të një "defekti".

"Në Tiranë kjo tablo nuk u aprovua, si "defekt" u gjet pse "koka e prerë" e shqiptarit te sulltani. Piktura u hodh si një gjë pa vlerë te magazinat e allçiut, te qendra e derdhjes në bronx ku ndodheshin edhe bustet e Enverit."

"Me vështirësi pas disa muajsh gjej një mjet i cili ma solli në studion time në Vlorë. Piktura që katandisur si mos më keq."

"Thasët e allçiut të hedhur sipër e kishin pluhurosur, telajoja ishte shtrembëruar, edhe korniza. Për ta rregulluar më është dashur me shumë kohë se ajo e realizimit."

Ndërkohë, pas izolimit të gjatë Shqipëria filloi të hapej në vitet 1990. Një i moshuar i cili jetonte në lagjen e piktorit, me origjinë nga Janina, kishte parë muzeun e Ali Pashë Tepelenës në Janinë dhe i sugjeron piktorit që t'i shkruante një letër, për t'i shitur pikturën.

"Ja dërguam letërën me një foto me ngjyra, në ato vite ishin të rralla këmbimet me postë. Edhe bashkia e Janinës përgjigjet po me letër, sepse ishte koha kur email-i nuk njihej fare."

Në foto: Agim Sulaj (i pari majtas), dita e dorëzimit të pikturës te përfaqësues të Bashkisë Janinë, viti 1990

"U vendos një ditë dhe një orar i caktuar, për një takim në doganën e Kakavijës ku edhe do të bëhej vlerësimi i pikturës."

"Tabloja "me kokën e prerë të Ali" u dërgua jo pa siklet" - shprehet autori. - "Grekët e blenë tablonë dhe prej vitit 1990 ndodhet atje. Ku është parë nga shumë

turistë e artdashës.”

Mediat e huaja, përfshirë BBC kanë dedikuar fragmente për tablonë e famshme.

Tabloja tjetër portreti i Ali Pashë Tepelenës, është realizuar në vitin 2006 gjatë ditëve që vija me pushime nga Italia në Vlorë. Një tjetër krijim i tij, i lindur nga fantazia dhe imazhi mbi Ali Pashë Tepelenën, të cilin ai thotë se e adhuron si personazh historik.

Pikturat e mjeshtrit Agim Sulaj, dedikuar Ali Pashë Tepelenë, u rikthyen në Porto Palermo dhe ndodhen në ambientet e brendshme të kalasë së Porto Palermos, përmes një marrëveshje institucionale mes dy vendeve. Pikturat tërheqin interesin e qindra turistëve të cilët e vizitojnë kalanë çdo ditë.

Piktori Agim Sulaj, duke pozuar para veprës së tij, në muzeun e Ali Pashë Tepelenës, në Janinë

“Vite më vonë më thanë që këto dy tablo janë të stampuara dhe ekspozuara, në Porto Palermo, ku qëndrojnë edhe sot.”
“Këto tablo janë bërë shumë të njohura dhe janë publikuar ndër vite në shume romane dhe krijime mbi Ali Pashain e Janinës” - shprehet ai.
“Këto tablo me suksesin e tyre më bindën që duhet të portretizoj historinë e thënë dhe të pathënë, të njohur e të panjohur të Shqipërisë,” shpreh piktori i mirënjohur.

Ndërkohë, shumica e veprave të tjera historike, realizuar nga Agim Sulaj, përfshirë ato të heroit tonë kombëtar, ndodhen sot në Vlorë te muzeu Selami, si dhe në koleksione private. /mapo/

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Rreth 90 banesa monument kulture në Gjirokastrë pritet të shpëtohen nga ndërhyrjet e shtetit

08:43 Kulturë

Arti përtej kohës

18:40 Kulturë

Sot 82-vjetori i Çlirimit të Beratit/ Homazhe në Varrezat e Dëshmorëve

18:22 Kulturë



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.